



Monitorimi i opinionit publik në qarkun Tiranë dhe qarqet e tjera, mbi rolin e policisë në jetën e përditshme të komunitetit


Në kuadrin e projektit “*Monitorimi i opinionit publik në qarkun Tiranë (krahsuar me qarqet e tjera) mbi rolin e policisë në jetën e përditshme të komunitetit*”, të financuar nga Programi Suedez për Forcimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri (SCPA), AGENDA Institute zhvilloi sondazhin e rradhës, në serinë e sondazheve periodike të parashikuara në këtë projekt. Sondazhi u realizua teknikisht nga statisticieni Eduard Zaloshnja, PhD. Metodologjia dhe gjetjet e këtij sondazhi janë përgjegjësi e autorit.

Përmes këtij projekti, synohet të monitorohet periodikisht opinioni i komuniteteve (në qarkun Tiranë, krahsuar me qarqet e tjera) në lidhje me punën e policisë në to. Vetë forma e sondazhit (elektronik) krijon mundësinë për kryerjen e tij brenda fare pak ditëve. Në këtë mënyrë, mund t'i jepet policisë një feedback i vazhdueshëm, që mund t'i vlejë për përmirësimin e punës në komunitet.


GJETJET KRYESORE TË SONDAZHIT TË TETORIT

- Në muajin janar ka patur një stabilitet të opinionit pozitiv të banorëve të qarkut Tiranë (16 vjeç e sipër), për punën e policisë së qarkut të tyre (është në nivelin 58%). Ndërkohë, ka patur edhe një ulje të opinionit negativ (ka zbritur në nivelin 21%). Rezultate të ndryshme vërehen në rang republike; ka një rënie domethënëse statistikisht të opinionit pozitiv për policinë e qarqeve (krahsuar me 6 muaj më parë), duke zbritur në nivelin 51%, ndërkohë që opinioni negativ ka mbetur stabël (Grafiku 1 dhe 2).

Grafiku 1. Qarku Tiranë: Çfarë vlerësimi keni në përgjithësi për punën e policisë së qarkut tuaj?




Grafiku 2. Shqipëria: Çfarë vlerësimi keni në përgjithësi për punën e policisë së qarkut tuaj?




- Rreth 61% e banorëve të qarkut Tiranë (16 vjeç e sipër) mendojnë se kriminaliteti është i ulët në zonat ku jetojnë. Ndërkohë, 10% mendojnë se është i lartë. Në pjesën tjetër të vendit, perceptimi për nivelin e kriminalitetit në zonat e banimit është ndjeshëm më i lartë. (Grafiku 3 dhe 4).

Grafiku 3. Qarku Tiranë: Në zonën ku jetoni, kriminaliteti është i ulët, mesatar, apo i lartë?




Grafiku 4. Shqipëria: Në zonën ku jetoni, kriminaliteti është i ulët, mesatar, apo i lartë?




- Banorët e qarkut Tiranë (16 vjeç e sipër) kanë ndjerë në muajin janar një prani të policisë në zonat ku jetojnë më të ulët krahasuar me tetorin. E ngjashme paraqitet situata në rang vendi. (Grafiku 5 dhe 6).

Grafiku 5. Qarku Tiranë: A e ndjeni praninë e policisë në zonën ku jetoni?




Grafiku 6. Shqipëria: A e ndjeni praninë e policisë në zonën ku jetoni?




- Rreth 60% e banorëve të qarkut Tiranë (16 vjeç e sipër) mendojnë se puna e policisë ndikon në parandalimin e vjedhjeve/grabitjeve/krimeve në zonat ku jetojnë. Ndërkohë, 23% e banorëve të këtij qarku mendojnë se nuk ndikon (një përmirësim i rezultateve krahsuar me tetorin). Rezultate të ngjashme vërehen në pjesën tjetër të vendit (Grafiku 7 dhe 8).

Grafiku 7. Qarku Tiranë: A mendoni se ndikon puna e policisë në parandalimin e vjedhjeve/grabitjeve/krimeve në zonën ku jetoni?




Grafiku 8. Shqipëria: A mendoni se ndikon puna e policisë në parandalimin e vjedhjeve/grabitjeve/krimeve në zonën ku jetoni?




- Rreth 48% e tiranase mendojnë se policia reagon shpejt ndaj vjedhjeve, grabitjeve, e krimeve të tjera në zonat ku jetojnë. Rreth 28% mendojnë të kundërtën. Perceptimi për regimin e policisë është më i ulët në qarqet e tjera (Grafiku 9 dhe 10).

Grafiku 9. Qarku Tiranë: A reagon shpejt policia ndaj vjedhjeve/grabitjeve/krimeve të tjera në zonën ku jetoni?




Grafiku 10. Shqipëria: A reagon shpejt policia ndaj vjedhjeve/grabitjeve/krimeve në zonën ku jetoni?




- Rreth 64% e banorëve të qarkut Tiranë (16 vjeç e sipër) mendojnë se puna e policisë ndikon në parandalimin e shkeljeve të kodit rrugor. Më shumë se çereku i banorëve të qarkut Tiranë mendojnë se puna e policisë rrugore nuk ndikon. Rezultate ndjeshëm më të këqia vërehen në pjesën tjetër të vendit (Grafiku 11 dhe 12).

Grafiku 11. Qarku Tiranë: A mendoni se ndikon puna e policisë rrugore në parandalimin e shkeljeve të kodit rrugor?



Grafiku 12. Shqipëria: A mendoni se ndikon puna e policisë rrugore në parandalimin e shkeljeve të kodit rrugor?



SHËNIME METODOLOGJIKE

- Në bashkëpunim me SCPA dhe Ministrinë e Brendëshme është hartuar pyetëtori tip, i përshtatshëm për anketim elektronik.
- Është krijuar një faqe e posaçme në internet me motor prodhimi sondazhi elektronik (që aktivizohet periodikisht), ku çdo vizitor unik ka mundësinë ta plotësojë pyetësin duke klikuar në opsionet e përgjigjeve.
- Është krijuar një baner i lidhur me një link me faqen e mësipërme, i cili i ekspozohet periodikisht çdo përdoruesi të internetit me banim në Shqipëri (16 vjeç e sipër), përmes reklamave në Facebook, Google Ads, Google Partners, Instagram, etj.
- Çdo banor i Shqipërisë (16 vjeç e sipër) me akses ndaj kompjuterëve, celularëve dhe tabletave ka probabilitet të ekspozohet ndaj këtij sondazhi elektronik.
- Faqja e anketimit elektronik mbyllet me plotësimin e kampionit prej 1400 të anketuarish, dhe aktivizohet periodikisht, për anketimin e popullsisë së targetuar, në mënyrë që të analizohet trendi i opinionit mbi punën e policisë në komunitet.
- Në qarkun Tiranë banojnë 698 nga të anketuarit në sondazhin e muajit tetor, ndërsa në qarqet e tjerë banojnë 702.
- Maksimumi i marzhit të gabimit statistikor në rang vendi është +/-2.8%, ndërsa për qarkun Tiranë është +/-3.6%.
- Shpërndarja e grup-moshave të kampionit është e ngjashme me atë të popullsisë së Shqipërisë (Grafiku 13).
- Kampioni u ripeshua para analizimit të tij, në mënyrë që ta përfaqësojë popullsinë shqiptare sa më mirë demografikisht dhe gjeografikisht.

Grafiku 13. Shpërndarja e grup-moshave të kampionit

